



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 27

Datë: 10. 02. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

2. Aktivitetet e ZRPPC-së

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për vazhdimin e kontratave për një pjesë të stafit jo permanentë:

4. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i shpenzimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut;

Shqyrtimi dhe miratimi i shpenzimeve të derivateve për muajt janar - dhjetor 2020:

4. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: Mirë se keni ardh! Po fillojmë. A ka dikush vërejtje. Rreth rendit të ditës, kërkuan shpjegime dhe dhanë shpjegime: Alim Rama, Sami Hamiti.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan rendin e ditës, edhe më një informatë nga aktivitetet e SKQZ-së.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj: Sekretariati më datën 8 mars, ka filluar rinumrimin e votave sipas vendimeve të PQZAP-së. Fillimisht, janë numruar votat me kusht, dhe pastaj me postë për subjektin e AAK-së. Më 9 mars, ka filluar procesi i votave sipas vendimit të PAAP-së, dhe bëhet fjalë për 134 vendvotime. Prej këtyre, 19 vendvotime, i janë nënshtruar rinumërimit të plotë. Procesi, ende është në vijim dhe, është pak më i komplikuar.

Ne, deri nesër e përmbylim procesin, dhe do të ju njoftojmë me një raport të detajuar. Ai, shpjegoi procesin, i cili do të detajohet mbi bazë tabelare...

Ibrahmi Selmanaj: Në këtë proces, ka pas parregullsi, mbase që kanë filluar prej qendrave të votimit, dhe përgjegjësia duket me qenë zingjirore, dhe të shkojë deri në fund. Këtu bëhet fjalë tash për tash për AAK-në, por me gjasë ka edhe te kandidatët tjerë. Dhe, unë kërkoh një rinumërim të plotë dhe, secili të përgjigjet për punën e tij...

Valdete Daka: Janë duke u bërë disa hetime, kemi persona të ndaluar nga policia. Unë nuk dua të deklarohem...Për ti hequr të gjitha dilemat, rreth një kandidateje të përfolur, ne i kemi numërua e rinumërua të gjitha votat, dhe pasi që ti kemi raportet e hetuesisë ne mund të shohim se çka ka ndodh...Objekt i hetimit, nuk janë të gjitha kutitë....134 kutitë nuk janë objekt i hetimit...Të shohim, nëse

ka probleme edhe këto mund të hetohen, pra nëse ka mospërputhje...Numërimi total i kutive në QNR, unë nuk kam ndonjë mendim, është vendim i krejt KQZ-së...

Sami Kurteshi: Kemi diskutuar, dhe unë nuk them që ky ka qenë procesi më i mirë i mundshëm zgjedhor. Por, kërkesa për rinumërim të plotë, i tejkalon edhe kërkesat ligjore. Mendoj se, dallimet e mospërputhjeve shihet ku janë...Janë pa...! Rinumrimi i plotë, merr karakter politik. Mendoj që s'ka shjenja... Ne kemi tërheqë vërejtjen vazhdimisht, mirëpo kërkesa për rinumërim të plotë atëherë, duhet ta pranojmë se krejt procesi ka qenë i kriminalizuar...Mendoj që duhet të shihet s'i problem, dhe unë jam hapur kundër kësaj...

Ibrahim Selmanaj: Është demokratik rinumërimi i votave: të vlerësohet, këtë e kërkon një subjekt...

Sami Kurteshi: Qasja ime ka qenë e qartë vazhdimisht. Vota e qytetarit nuk vendoset në tavolinë, por në kuti. Transparenca e plotë në proces, është vlera më e madhe që i jepet publikut. Nëse, ne e pranojmë këtë fakt, ne duhet të bëjmë një hetim të plotë, por duhet të ketë diçka shumë të madhe që kjo të bëhet...

Në debat, morën pjesë edhe: Valdete Daka, Sami Hamiti, i cili tha se subjektet politike e kanë pranuar dhe se, kjo është më shumë një kërkesë morale e kolegut. Pastaj, diskutoi edhe Arianit Elshani i cili tha se, drejtësia duhet të kryej punën e vetë, kurse nëse shfaqen mospërputhje të tjera të shohim...se s'i do të procesojmë... Alim Rama tha se, deri tash nuk kemi pasur dallime ose mos përputhje të mëdha, dhe se nuk pajtohet me rinumërim të plotë të kutive...Diskutuan edhe: Burim Ahmetaj që raportoi se QNR është në prag të përfundimit të procesit, dhe mendoj se nesër përfundon...

3.Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për vazhdimin e kontratave për një pjesë të stafit jo permanentë:

Gordana Llaban: Ju përshëndes të gjithëve. Dje jemi takuar në këshillë dhe kemi diskutuar, dhe nga ato që kemi shqyrtuar, janë dy çështje që po i prezantoj: një, informata lidhur me rekrutimin e vendit të përhershëm të punës në Sekretariat. Janë tri pozicione për vitin 2021. Pra, e para, është Zyrtari i Lartë i Listës Votuese. Njëherë është procesi por, për shkak të gjendjes së covidit është prolongu. Tash, duhet sërish të iniciohet konkursi.

E dyta, është pozicioni i KKZ-së në Mamushë për shkak se zyrtari aktual, shkon në pension më 15 mars. Dhe, duhet po ashtu, edhe zyrtari i KKZ-së në Lipjan, që po ashtu shkon në pension. Për shkak të afateve ligjore, duhet sa më shpejtë të fillojnë procedurat e shpalljes së konkurseve. Është edhe një rekomandim: që zyrtarëve jo permanent që u skadon sot afati, të ju shtyhet deri më 31 mars, sepse ne ende jemi në përmbyllje të procesit. E keni tabelën se, pse këtyre personave duhet të vazhdohen.

Janë gjithsej: 81 persona.

Alim Rama, tha se, më mirë nëse ka mundësi të shtyhen tri pozitat permanente deri të përmbillet procesi. Kurse, për stafin jo permanent, mungon arsyeshmëria e shtyrjes së angazhimit të tyre... Po ju rikujtoj që, kërkesat e ZRPP-së nuk janë shqyrtuar, kërkesat e tij... Ai, bëri vërejtje rreth këtyre kërkesave, dhe se Sekretariati nuk ka dhënë vlerësim se pse disa kërkohet të shtyhet angazhimi, e pse për disa jo...

Lidhur me këto çështje, dha shpjegime më të detajuara Burim Ahmetaj, kryeshef i cili, bëri edhe arsyeshmëritë e nevojshme... Ai tha se, kjo është kërkesë e Sekretariatit...

Alim Rama, nuk u pajtua me këto shpjegime, sidomos tha se nuk ka pasur planifikime të duhura...

Në diskutim u angazhua edhe Eshref Vishi, i cili tha se kërkesat janë shqyrtuar edhe në personel. Pastaj, edhe Sami Hamiti, i cili tha se kostoja financiare mbulohet, Arianit Elshani, Yll Buleshkaj (ZRPP), Burim Ahmetaj (Sekretariati), Sami Kurteshi, Aratan Asllani

Valdete Daka: Kush është për këtë rekomandim. Miratohet...

4. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i shpenzimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut:

Sami Hamiti: Në këshill, sot kemi shqyrtuar shpenzimet për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut. Kemi pasur dy – tri plotësime, vërejtjet dhe ato duket që janë bërë. Është buxhet që është shpenzuar nën 52%, sepse nuk kemi pasur raund të dytë. Dhe ne, rekomandojmë për aprovim...

Valdete Daka: Sa për informim, janë shpenzuar gjithsej: 359, 057 euro. Shpenzimet për një votues, kanë qenë 3.2 euro...

Sami Kurteshi: E kam pa raportin. Kamë dy – tri pyetje: ai, pyeti rreth shpenzimit të derivateve...Nuk ka të dhëna... Dhe, pyeti rreth “drekave zyrtare”. Qysh, çka kanë qenë këto dreka... ?

Alim Rama, pyeti rreth “shpenzimeve të përfaqësimit”!

Sami Hamiti: Ne, e kemi parë raportin tjetër të shpenzimeve: janë veturat e marra nga MPB. Mbi dy pyetjet tjera, u dhanë po ashtu shpjegime...

Miratohet ky raport...

4.Të ndryshme.